



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KOMUNA E LIPJANIT**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**



**REPUBLIKA KOSOVA**  
**OPSTINA LIPJAN**  
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

---

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	02.04.2026
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkryetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – MARS 2026

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2026, ju dorëzon:

**RAPORTIN MUJOR**  
**TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.03.2026-31.03.2026**

## PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kërkesave të bartura. Gjatë muajit mars 2026-janë pranuar gjithsejtë 50<sup>1</sup>-kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura nga muaji paraprak kanë qenë 13 lëndë, në total 63 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 48 kërkesa, 35 të miratuara, 11 të refuzuara, 1 pushim procedure dhe 1 e bartur për shqyrtim në gjykatë. Për shqyrtim në muajin vijues (prill 2026) barten 15 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuar dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e shqyrtimit të kërkesave është vazhduar me intensifikimin e angazhimeve për shqyrtimin e tyre brenda afateve ligjore.

Pjesë e veçantë e shqyrtimit të kërkesave është edhe procedura e lëshimit të konkluzioneve për pagesen e taksave sipas kategorive të caktuara. Lidhur me këte janë lëshuar 17 konkluzione për pagesen e taksave. Prej tyre 5 konkluzione për leje ndërtimi, 2 për leje mjedisore komunale, 4 për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimi, 4 për leje rrënimi dhe 2 për certifikatë legalizimi

Po, ashtu DPUMM ka përgatitur dhe adresuar te palët ftesa për plotësimin e dokumentacionit. Në kuadër të kësaj janë lëshuar 2 ftesa për kompletim të lëndës. Brenda muajit mars është pranuar një kërkesë për plotësimin e lëndës. Edhe gjatë këtij muaji kishte mjaft kërkesa të drejtpërdrejta (informative) lidhur me ndryshimin/plotësimin e HZK<sup>2</sup>.

Aktivitete të tjera janë kryer edhe si:

Janë proceduar administrativisht të gjitha kërkesat për kryerjen e pagesave sipas detyrimeve të arritura. Po ashtu është hartuar Plani i shpenzimeve për vitin 2026 dhe Plani i të hyrave deri në vitin 2029.

Është në zbatim e sipër programi për regjistrimin e adresave zyrtare. Procesi mbikëqyret drejtpërdrejt nga DPUMM. Gjatë muajit mars 2026-janë regjistruar 143-qytetarë në sistemin e adresave dhe janë lëshuar 143 certifikata.

Është përgatitur materiali për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2026 -2031 dhe është proceduar në Drejtoratin e Prokurimit.

Lidhur me aktivitetet për PZHK, gjatë muajit mars është trajtuar rishikimi i Planit të Veprimit dhe pjesa për profilin e PZHK-së.

### **Aktivitetet themelore për muajin vijues:**

- *Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të bartura;*
- *Fillimi i zbatimit të vendimeve të miratuara në seancen e Kuvendit të Komunës të mbajtur me 24.03.2026.*
- *Çështja e menaxhimit të regjistrimit të adresave pas plotësimit të pozitave të punës lidhur rme këtë çështje.*

<sup>1</sup> Janë pranuar edhe 2 kërkesa të tjera për plotësim dokumentacioni bazuar në kërkesat e parashtruara paraprakisht.

<sup>2</sup> Këto kërkesa duhet të trajtohen në procesin e ndryshim/plotësimit të HZK-së.

- Vazhdimi i punimeve në draft PZHK.

## STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

**Tabela 1.**

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuar	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Pushim procedure -pezullim	Të refuzuar	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	9	1	4		2		4
2.	Leje ndërtimi	11	5	7		5		4
3.	Leje rrënimi	5		5				
4.	Informacione urbane	7		6				1
5.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	5	2	2		1		4
6.	Legalizimi/ Në listë të pritjes							
7.	Bashkim/ndarje e parcelave	4		3		1		
8.	Kërkesë për LMK	2	2	2	1			1
9.	Qasje në dokumente	1		1				
10.	MMPHI – mirat. ankese		1				1 <sup>3</sup>	
11.	Pëlqim për rrjet energj.		1			1		
12.	Ndërrimi i dest. të tokës	1				1		
13.	Tërheqje lënde	1		1				
14.	Plotësim i K. Ndërtim.	1		1				
15.	Vazhdim afati LMK							
16.	Kërkesë për konfirmim aplikimi	1		1				
17.	Dokumente për përfaqësuesin ligjor	1		1				
18.	Riemërtim rruge	1						1
19.	Shtyerje afati legalizim							
20.	Pyetësori për PAK <sup>4</sup>		1	1				
21.	Raporti për menxh. e mbeturinave							
	Gjithsejtë:	50	13	35	1	11	1	15

*Sipërfaqja tokësore për ndërtim, sipërfaqja e ndërtesave dhe destinimi*

**Tabela 2.**

Nr.	Kategoria e ndërtimit	Sipërf. Tokës – m <sup>2</sup>	Sip.nderësës- m <sup>2</sup>	Destinimi	Vendi
1.	I	2000	985.28	Afarist	Grackë e Vjetër
2.	I	945	366.64	Afarist	Konjuh
3.	I	1861	418.66	Shtëpi	Lipjan
4.	I	2070	418.63	Shtëpi	Lipjan

<sup>3</sup> Lidhur me një vendim të MMPH për miratimin e ankesës, lënda është dërguar në contest administrativ në Gjykatë.

<sup>4</sup> Në Raport janë prezantuar të dhënat lidhur me ndërtesat me leje që plotësojnë kërkesat teknike për qasje të personave me aftësi të kufizuara.

5.	II	3000	1836.92	Qerdhe/kopsht	Magure
	Gjithsejtë	9876	4026.13		

Tokë e shfrytëzuar vetëm për afarizëm = 2945 m<sup>2</sup> me gjithsejtë ndërtim për afarizëm prej 1351.92 m<sup>2</sup>, kurse tokë e shfrytëzuar për banim në qytet 3931m<sup>2</sup> në të cilën janë dhënë për ndërtim të 837.29m<sup>2</sup> (shtëpi).

### **Buxheti:**

Gjatë muajit mars 2026 të hyrat nga kategoritë e ndryshme nga fusha urbane janë realizuar shumat si në vijim:

- Të hyrat për leje ndërtimore janë realizuar në shumë prej:.....230,418.61<sup>5</sup>€
- Të hyrat për ndërrimin e destinimit të tokës në shumë prej: .....29,085.00€
- Të hyrat për leje mjedisore komunale janë realizuar në shumë prej.....5,541.40€
- Të hyrat për legalizimin e ndërtesave pa leje janë realizuar në shumë prej:.....969.34€
- Të hyrat për Leje rrënimi janë realizuar në shumë prej .....636.89€

Shuma totale e të hyrave: .....266,651.24€

*Të dhënat lidhur me të hyrat për muajin mars 2026 janë pranuar nga sektori i financave në kuadër të Drejtoratit përkatës të Komunës së Lipjanit.*

Lidhur me shpenzimet kemi proceduar me pagesa për kryerjen e detyrimeve të maturuara për muajin mars 2026. Mjetet e planifikuara për shpenzim janë nga kategoria ekonomike “Mallra dhe shërbime”.

### **DISKUTIME PUBLIKE:**

Gjatë muajit mars 2026 nuk kemi pasur ndonjë diskutim publik.

<sup>5</sup> Shuma prej 196,486.69€ e paguar me 27.02.26 për Leje ndërtimi, nuk është prezantuar në Raportin e muajit shkurt, meqenëse sipas Drejtoratit të financave kjo shumë është regjistruar në muajin mars, prandaj e njehta është prezantuar në këtë Raport.